

Qëndrim i Komisionerit lidhur me mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për trajtimin financiar në favor të nëpunësve civilë gjyqfitues, të cilët rezultojnë të punësuar në një institucion tjetër shtetëror ose privat

Gjatë procesit të verifikimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Komisioneri është njohur me problematikat që kanë hasur institucionet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si për risistemimin e gjyqfituesve në të njëjtin pozicion pune apo të barazvefshmëm me të, ashtu edhe për mënyrën e pagimit të pagave mujore nga momenti i shkëputjes së marrëdhënies së shërbimit civil deri në rikthimin e tyre në detyrë.

Duke parë vështirësinë e këtij procesi, Komisioneri ka zhvilluar në selinë e tij seanca dëgjimore dhe gjatë këtyre proceseve është konstatuar se disa nëpunës civilë gjatë periudhës në pritje të ekzekutimit të vendimit gjyqësor janë punësuar në një institucion tjetër. Nga analiza e dokumentacionit të administruar në këtë proces, pothuajse të gjitha institucionet nuk kanë vepruar drejt lidhur me këtë çështje, pasi rezulton se këto pagesa janë kryer në formën e një dëmshpërblimi, i cili lëvrohej në periudha të ndryshme kohore.

Për t'i ndihmuar institucionet, Komisioneri, në kuadrin e bashkëpunimit institucional, i është drejtuar institucioneve të specializuara që janë Kontrolli i Lartë i Shtetit, Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike, duke kërkuar prej tyre që të unifikojnë qëndrimin për këtë rast. Kontrolli i Lartë i Shtetit është përgjigjur në lidhje me këtë aspekt duke hartuar një udhëzim për inspektorët e KLSH, në lidhje me mënyrën se si duhet të veprojnë institucionet në këto raste.

Edhe më herët, Komisioneri, për t'i dhënë një zgjidhje ligjore këtij problemi kaq kompleks, ka orientuar institucionet se duhet të analizojnë me kujdes urdhërimet e gjykatës të përmbledhura në dispozitivin e vendimit. Në pjesën më të madhe të rasteve Gjykatat kanë konkluduar se aktet administrative përmes të cilave janë ndërprerë marrëdhëniet në shërbimin civil kanë qenë absolutisht të pavlefshme, vështruar nenit nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i cili parashikon se:

“Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.”

në këto raste, marrëdhënia e shërbimit civil konsiderohet e pandërprerë dhe të dyja palët duhet të respektojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rregullojnë këtë marrëdhënie të përcaktuara qartësisht në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, edhe për aktet të cilat Gjykata i ka vlerësuar të paligjshëm, referuar nenit 63 e vijues dhe 66/1 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është urdhëruar rikthimi i nëpunësit në detyrë dhe pagimi i pagave mujore nga momenti i ndërprerjes së tyre. Në këtë këndvështrim, të gjitha vendimet gjyqësore që për objekt kanë

patur shqyrtimin e ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil, në përfundim të tyre, kur Gjykatat kanë konstatuar mosrespektim të ligjit, si të ligjit material ashtu edhe atë procedural, **kanë vendosur vazhdimin e marrëdhënies së shërbimit nga momenti i ndërprerjes së saj.**

Vazhdimi i marrëdhënies nënkupton njohjen e të drejtave dhe detyrimeve që kanë të dyja palët në këtë marrëdhënie: institucioni për t'i paguar pagën nëpunësit dhe nëpunësi për të provuar se vijon t'i plotësojë përsëri kriteret për të qenë nëpunës civil dhe të shprehë gatishmërinë e tij për të vijuar marrëdhënien e shërbimit civil.

Mirëpo, nga koha e dhënies së vendimit gjyqësor e deri në çastin e ekzekutimit të tij mund të ndryshohen rrethanat të cilat ndikojnë në marrëdhënien e shërbimit civil, apo ndikojnë në vlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Në disa raste nëpunësi mund të jetë punësuar në një institucion tjetër, e drejtë që garantohet nga neni 49, i “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, ku sanksionohet se:

“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë”

Gjendur përpara faktit që, nga njëra anë për shkak se procesi gjyqësor është tejzgjatur në lidhje me respektimin e afateve procedurale të shqyrtimit të një mosmarrëveshje administrative, nëpunësit i duhet të punonte për të siguruar mjetet e jetesës dhe nga ana tjetër, me rikthimin e marrëdhënies së shërbimit civil nëpunësit, referuar nenit 47, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, i ndalohet të kryejë veprimtari me pagesë jashtë detyrës së tij në shërbimin civil pa marrë leje nga titullari i institucionit, situata bëhet komplekse.

Për këtë arsye, Komisioneri rekomandon që të tregohet kujdes në pagimin e pagave për këta nëpunës. Komisioni i Posaçëm i ngritur pranë institucionit fillimisht duhet të marrë në analizë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me nëpunësin civil. Siç është shprehur më sipër, marrëdhënia e shërbimit civil konsiderohet e pandërprerë e për këtë arsye, është detyra e këtij Komisioni të verifikojë nëse nëpunësi vazhdon t'i plotësojë kriteret për të qenë nëpunës civil. Në rast se, nëpunësi i plotëson kriteret vijohet me verifikimin e pagesave që mund të ketë përfituar kreditori nga institucione shtetërore apo private, për të eliminuar në këtë mënyrë një përfitim pa të drejtë në favor të nëpunësit dhe në dëm të shtetit.

Institucioni duke respektuar afatet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, fillimisht duhet të njoftojë Përmbauesin Gjyqësor që është ngarkuar për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë, për punësimin e nëpunësit civil duke i parashtuar atij të gjitha argumentet ligjore si më sipër dhe duke kërkuar prej tij që në llogaritjen e detyrimit të zbriten pagesat që nëpunësi ka përfituar nga institucioni tjetër. Në rast se, nuk arrihet dakordësia me përmbauesin dhe kreditorin lidhur me vlerën monetare që duhet të paguhet në favor të nëpunësit gjyqfites, atëherë institucioni duhet t'i drejtohet Gjykatës kompetente për zgjidhjen e çështjes.

Në llogaritjen e vlerës së detyrimit duhet të tregohet kujdes në këto aspekte:

- ✓ Për rastet kur nëpunësi gjatë kësaj periudhe ka përfituar një pagë më të ulët se ajo që do të përfitonte në rast se marrëdhënia e shërbimit civil nuk do të ndërpritej, institucioni detyrohet të plotësojë këtë pagë deri në vlerën e pagës që nëpunësi përfitonte në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së shërbimit.
- ✓ Kujdes duhet të tregohet edhe në llogaritjen e detyrimit për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor që duhet paguar në favor të nëpunësit.

Duke vepruar në këtë mënyrë, nga njëra anë respektohen të drejtat e nëpunësit për t'u paguar për punën e kryer dhe njëkohësisht ai ka të drejtë të zgjedhë mes pozicionit të punës që i ofrohet nga Komisioni i Posaçëm dhe pozicionit që mban në ndonjë institucion tjetër.

Në një rast të tillë, institucioni duke vlerësuar që faktet kanë ndryshuar nga ato të paraqitura në gjykim, pasi nëpunësi nuk është më i papunë, por paguhet nga një institucion tjetër shtetëror, duke gjetur mbështetje në nenin 609, të Kodit të Procedurës Civile” i cili ka parashikuar se:

“Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas....

Kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor ose vendim arbitrazhi, debitori mund të kundërshtojë ekzekutimin e titullit vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së këtyre vendimeve”

mund apo duhet t'i drejtohet Gjykatës, duke kërkuar pavlefshmëri të pjesshme të titullit ekzekutiv (që në këtë rast është vendimi gjyqësor i formës së prerë) dhe më tej, është Gjykata ajo që vendos nëse duhet ose jo të merren parasysh këto rrethana, duke mos e lënë rastin, në zgjedhjen subjektive të nëpunësit gjyqfitues.

Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përmbledhjen e publikuar me auditime të ushtruara për periudhën janar-shtator 2017, nga ku rezulton se janë konsideruar dëm ekonomik pagesat e kryera për punonjësit të cilët kanë fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë, pagesën deri në rikthim në punë, në kushtet kur këta punonjës kanë qenë në marrëdhënie pune me institucione të tjera shtetërore ose private.

Këto pagesa, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, janë konsideruar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjektit dhe është rekomanduar marrja e masave disiplinore dhe administrative ndaj nëpunësve përgjegjës.

Në këtë përfundim Komisioneri ka arritur, ndër të tjera, edhe duke analizuar disa praktika gjyqësore, dhe për këtë arsye, vlerësojmë që konkluzionet e arritura nga gjykata duhet të shërbejnë edhe gjatë administrimit të shërbimit civil, për të marrë masat nevojshme për

të mos përsëritur më të njëjtat gabime në të ardhmen dhe për të unifikuar praktikën në të gjitha subjektet e shërbimit civil.